

KODI I

# SJELLJES ANTI KORRUPSION

# PËRMBAJTJA

|                                                                                |           |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>MESAZH I PRESIDENT-DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM</b>                            | <b>3</b>  |
| <b>PSE NJË KODI I SJELLJES ANTIKORRUPSION VINCI?</b>                           | <b>4</b>  |
| <b>RREGULLAT E PËRGJITHSHME</b>                                                | <b>5</b>  |
| Përkufizimi i korrupsionit                                                     | 5         |
| Kuadri ligjor                                                                  | 5         |
| Korrupsioni dhe aktet e paligjshme që shoqërohen me të                         | 6         |
| Konflikti i interesit                                                          | 6         |
| Parandalimi i korrupsionit është çështje e të gjithëve                         | 7         |
| <b>RREZIQET E KORRUPSIONIT NË PROFESIONET E GRUPIT</b>                         | <b>8</b>  |
| Në kuadrin e projekteve, kontratave/tenderëve publikë ose privatë              | 8         |
| Në kuadrin e marrëdhënieve me agjentët publikë                                 | 10        |
| Situata të tjera                                                               | 10        |
| <b>RREGULLA TË SJELLJES DHE KËSHILLA</b>                                       | <b>11</b> |
| Marrëdhëniet me klientët në kuadrin e kontratave/tenderëve publikë ose privatë | 12        |
| Përdorimi i një ofruesi shërbimi                                               | 13        |
| Pagesat e lehtësimit                                                           | 15        |
| Dhurata biznesi dhe ftesa                                                      | 17        |
| Kontributet politike, sponsorizimi dhe patronazhi                              | 20        |
| <b>ZBATIMI</b>                                                                 | <b>22</b> |
| Roli i entiteteve të Grupit                                                    | 22        |
| Roli i bashkëpunëtorëve                                                        | 22        |
| Mekanizmi i alarmit të brendshëm                                               | 22        |
| Regjimi disiplinor - ndëshkimet                                                | 22        |

# MESAZH I PRESIDENT-DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



**Manifesti** ynë promovon respektin e parimeve etike.

**Karta jonë e etikës dhe sjelljes** formalizon rregulla të sjelljes që janë të detyrueshme për të gjitha ndërmarrjet tona dhe të gjithë bashkëpunëtorët tanë.

Lufta kundër korrupsionit qëndron në radhën e parë të këtyre parimeve. Është fjala jo vetëm që secili nga bashkëpunëtorët e grupit VINCI të përqafojë një sjellje të paqortueshme, por gjithashtu të marrë pjesë, në kuadrin e veprimtarive të tij, në mekanizmin e parandalimit të korrupsionit.

Ky mekanizëm mbështetet pikërisht në këtë Kod të sjelljes antikorrupsion, në identifikimin e rreziqeve të korrupsionit dhe vënien në jetë të aksioneve të parandalimit.

Objekti i këtij Kodi të sjelljes është të shpjegojë rregullat e shprehura në Kartën tonë të etikës dhe sjelljes, në fushën e luftës kundër formave të ndryshme të korrupsionit.

U kërkoj drejtuesve të qendrave tona të profesioneve ta shpërndajnë atë pranë ekipeve të tyre sipas formës që do t'u duket më efektive për të siguruar respektimin e tij, duke e plotësuar nëse është e nevojshme, në varësi të veçantive të veprimtarive dhe të vendeve të interesuara.

**Xavier Huillard,**

president-drejtor i përgjithshëm i VINCI

# PSE NJË KODI I SJELLJES ANTIKORRUPSION VINCI?

Korrupsioni është një sjellje që dëmton rëndë ekonominë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe efikasitetin e tregtisë ndërkombëtare dhe kombëtare duke shtrembëruar lojën e konkurrencës në dëm të konsumatorëve dhe të ndërmarrjeve. Prandaj **korrupsioni është i paligjshëm** praktikisht në të gjitha vendet e botës.

## VINCI DUHET TË JETË SHEMBULLOR.

Grupi VINCI e vlerëson kështu korrupsionin si të papranueshëm.

Çdo bashkëpunëtor i Grupit duhet të ketë një sjellje të paqortueshme në fushën e luftës kundër korrupsionit.

Grupi VINCI ka shprehur angazhimin e tij në favor të luftës kundër korrupsionit:

- Duke u anëtarësuar që në vitin 2003 në **Paktin Global të Organizatës së Kombeve të Bashkuara**, parimi 10-të i të cilit është: “Ndërmarrjet ftohen të veprojnë kundër korrupsionit në të gjitha format e tij përfshi këtu zhvatjen dhe ryshfetin.”
- Nëpërmjet **Kartës së etikës dhe sjelljes VINCI**, e cila përcakton rregullat e sjelljes që duhen përvetësuar nga secili bashkëpunëtor i Grupit. Midis këtyre rregullave figurojnë respektimi i ligjshmërisë dhe lufta kundër korrupsionit.
- Nëpërmjet **Manifestit VINCI**, angazhimi nr. 2 i të cilit është: “Etika është në qendër të kontratave tona dhe të marrëdhënieve me klientët tanë. Ndërmarrjet tona e zbatojnë Kartën tonë të etikës kudo në botë.”

Grupi VINCI i ushtron veprimtaritë e tij në shumë vende përmes filialeve të shumta. Reputacioni i Grupit varet nga çdo filial dhe nga çdo bashkëpunëtor i Grupit; çdo filial dhe çdo bashkëpunëtor i Grupit duhet t’u nënshtrohet standardeve më të rrepta.

Objektivi i këtij Kodi të sjelljes antikorrupsion është të ndihmojë bashkëpunëtorët të kuptojnë dhe të zbatojnë rregullat e etikës të Grupit të shprehura në Kartën e etikës dhe sjelljes.

Ai shpjegon mënyrën se si rreziqet e korrupsionit mund të ndeshen me gjatë veprimtarive të Grupit. Ai jep gjithashtu përgjigje për pyetjet që bashkëpunëtorët mund të bëjnë, kur ndeshen me situata që paraqesin një rrezik korrupsioni. Ky Kod i sjelljes saktëson çka është e ndaluar dhe çka lejohet ose rastet kur bashkëpunëtorët duhet të kërkojnë ndihmë.

Të gjitha situatat që mund të ndeshen nuk janë trajtuar në mënyrë shteruese. Secili duhet të tregojë urtësi dhe t’u referohet sistematikisht, kur është rasti, rregullave specifike të përpunuara nga qendra e tij ose shoqëria të cilës i përket.

Në rast vështirësie në interpretimin e rregullave të sjelljes së këtij Kodi, çdo bashkëpunëtor ftohet të shkëmbejë me eprorin e tij hierarkik, juristët dhe personat e ngarkuar me etikën në shoqërinë të cilës i përket, në qendrës ose në Grupin e tij.



# RREGULLAT E PËRGJITHSHME

## Përkufizimi i korrupsionit

Korrupsioni është<sup>(1)</sup>: “kërkimi, ofrimi, dhënia ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i një përfitimi të paligjshëm, ose një tjetër **avantazhi të pamerituar** ose premtimi i një avantazhi të tillë të pamerituar, **që ndikon në ushtrimin normal të një funksioni** ose sjelljen e **kërkuar nga përfituesi** i përfitimit të paligjshëm, ose i avantazhit të pamerituar ose i premtimit të një avantazhi të tillë të pamerituar.”

**Kjo është një sjellje e pandershme që përfshin në praktikë të paktën dy aktorë:**

- atë që do të përdorë në mënyrë mashtruese kompetencat ose ndikimin e tij për të favorizuar një të tretë kundrejt një avantazhi;
- dhe atë që do të propozojë ose japë këtë avantazh.

Përveç kësaj, një person që lehtëson një akt korrupsioni është një **bashkëpunëtor**, dhe ai që përfiton nga ky akt duke marrë avantazhin e pamerituar është një **marrës**. Ata janë njësoj përgjegjës. E drejta franceze e barazon korrupsionin **me ndikimin e paligjshëm**.

**Një vepër korrupsioni ekziston edhe:**

- nëse ai që propozon avantazhin vepron përmes një të treti (një ndërmjetësi, një agjenti tregtar, një nënkontraktori, një furnizuesi, një partneri etj.);
- nëse ai që e merr avantazhin nuk është përfituesi i tij fundor (përfituesi mund të jetë një i afërm, një i tretë etj.);
- nëse veprimi mashtrues dhe dhënia e avantazhit të pamerituar nuk ndodhin njëkohësisht (avantazhi i pamerituar mund të jepet paraprakisht, ose të jepet më vonë);
- nëse avantazhi i pamerituar merr formë të tjera përveç dhënies së parave (mund të bëhet fjalë për objekte materiale, dhënie shërbimesh, përfitim reputacioni etj.);
- nëse përfituesi është një punonjës i sektorit publik ose i sektorit privat.

## Kuadri ligjor

Ekzistojnë:

- nga njëra anë, në çdo vend, ligje që përkufizojnë korrupsionin dhe përcaktojnë ndëshkimet e zbatueshme për këtë vepër, zbatimi i të cilave u takon autoriteteve vendore të vendit të interesuar;

(1) Burimi: Konventa civile mbi korrupsionin e Këshillit të Evropës, miratuar më 04/11/1999 dhe në fuqi më 01/11/2003.

- dhe nga ana tjetër, në disa vende (p.sh.: SHBA<sup>(2)</sup>, Mbretëri e Bashkuar<sup>(3)</sup>, Francë<sup>(4)</sup>) ligje me ndikim ekstra-territorial që u lejojnë autoriteteve të këtyre vendeve të ndëshkojnë aktet e korrupsionit të kryera nga persona dhe shoqëri jashtë kufijve të tyre. Kështu, personat që i shkelin këto rregulla u ekspozohen ndjekjeve penale në të njëjtën kohë në shumë vende për të njëjtat vepra;
- konventa ndërkombëtare, në të cilat këto vende janë anëtarësuar.



Ky Kod i sjelljes antikorrupsion nuk i trajton të gjitha rregulloret vendore që mund të jenë më detyruese se rregullat e këtij Kodi.

Çdo bashkëpunëtor i Grupit duhet të informohet mbi të drejtën e zbatueshme në nivel vendor pranë shërbimeve kompetente të entitetit të cilit i përket.

## Korrupsioni dhe aktet e paligjshme që shoqërohen me të

Korrupsioni shoqërohet shpesh me akte të paligjshme si ndikimi i paligjshëm, favoritizmi, paraqitja e deklaratave financiare të pasakta, keqpërdorimi i aseteve të kompanisë, zhvatja, abuzimi me detyrën, pasurimi i paligjshëm. Këto akte përbëjnë vepra penale të mirëfillta në shumicën e vendeve dhe mund të nënkuptojnë ekzistencën e një akti korrupsioni. Prandaj çdo punonjës duhet të jetë mjaft vigjilent.

## Konflikti i interesit

Karta e etikës dhe sjelljes e VINCI përcakton rregulla në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit.

Bashkëpunëtorët e Grupit mund të marrin vërtet propozime, oferta ose dhurata nga ana e të tretëve (furnizues, nënkontraktorë, ofrues shërbimesh, për shembull). Atëherë, sipas rrethanave, ata mund të ndodhen në një situatë konflikti interesi, e cila në disa raste mund të barazohet me korrupsionin pasiv.

Misioni profesional i çdo bashkëpunëtori nuk duhet të hyjë në konflikt me interesin e tij personal. Nëse paraqitet një situatë e tillë, bashkëpunëtori në fjalë duhet të informojë menjëherë për këtë eprorin e tij hierarkik.

(2) Foreign Corrupt Practices Act ose "FCPA" amerikane zbatohet jo vetëm për shtetasit ose rezidentët amerikanë, por edhe për personat juridikë ose fizikë që përdorin mjete komunikimi ose pagese që përfshijnë një tranzit përmes SHBA (përdorimi i US\$, përdorimi i postës elektronike, udhëtimeve në SHBA etj.) ose për të cilët do të vërtetohet se kanë marrë pjesë në një konspiracion (përkufizim jo shterues).

(3) UK Bribery Act anglez përmban rregulla që lejojnë, në disa kushte të caktuara, të ndiqen persona të huaj për vepra të kryera jashtë shtetit. Ai është i zbatueshëm për shoqëritë e huaja që ushtrojnë të gjitha ose një pjesë të veprimtarive të tyre në Mbretërinë e Bashkuar.

(4) Ligji nr. 2016-1691 i 9 dhjetorit 2016 mbi transparencën, luftën kundër korrupsionit dhe modernizimin e jetës ekonomike (i quajtur "Ligji Sapin II"). Autoritetet gjyqësore franceze mund të ndjekin shtetas francezë për vepra të kryera në Francë ose jashtë saj, të huaj për vepra të kryera në Francë, ose të huaj për vepra të kryera jashtë shtetit, me kusht që ata të kenë vendbanimin e zakonshëm në Francë ose të ushtrojnë një pjesë të veprimtarisë së tyre profesionale në Francë.

## Parandalimi i korrupsionit është çështje e të gjithëve

Korrupsioni bën që mbi ndërmarrjet dhe bashkëpunëtorët e tyre të rëndojnë rreziqe të rëndësishme ndëshkimesh (dënim me burg, gjoba të konsiderueshme, ndalim të ushtrimit të veprimtarisë, përjashtim nga tenderët publikë dhe/ose financimet ndërkombëtare etj), si dhe për reputacionin.

Përtej ndëshkimeve penale, korrupsioni mund të ketë pasoja edhe në fushën civile dhe kontraktore (prishje kontratash, zhdëmtime të të tretëve të dëmtuar etj.).

Nga çdo bashkëpunëtor i Grupit pritët:

- që të njihet me Kartën e etikës dhe sjelljes dhe me këtë Kod të sjelljes antikorrupsion;
- që të marrë pjesë në aksionet e trajnimit në fushën e luftës kundër korrupsionit të organizuar brenda Grupit (veçanërisht modulet e e-learning), të qendrës së tij dhe të entitetit të cilit i përket.

---

▶ **Çdo entitet i Grupit dhe çdo bashkëpunëtor duhet ta zbatojnë këtë qasje për parandalimin e korrupsionit, për pjesën që u përket.**

---



▶ **Karta e etikës dhe modulet e e-learning janë në dispozicion të të gjithë bashkëpunëtorëve në intranetin e VINCI-t.**



# RREZIQET E KORRUPSIONIT NË PROFESIONET E GRUPIT

Veprimtaria e shoqërive të grupit VINCI konsiston në lidhjen dhe ekzekutimin e kontratave ose tenderëve që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe pajisjet, për autoritete publike ose klientë privatë dhe kjo, në mbarë botën.

Gjatë këtyre veprimtarive, ekzistojnë situata të ndryshme, në të cilat bashkëpunëtorët mund të ndodhen përballë një rreziku korrupsioni. Në vijim jepen shembuj të situatave të përgjithshme që mund të krijojnë vepra korrupsioni.

## Në kuadrin e projekteve, kontratave/ tenderëve publikë ose privatë

### MOTIVET QË MUND TË ÇOJNË NË AKTE KORRUPSIONI:

- Të kërkojnë favorizime për marrjen e një kontrate ose të një tenderi.
- Të kërkojnë të ndodhesh në një situatë të privilegjuar (rregulla të favorshme parakualifikimi, kriteret e dhënies, mekanizma kontraktualë).
- Të kërkojnë të merren vendime të favorshme (shtyrje afatesh, punime shtesë, konfirmim sasish, shtesa kontrate, reklamime, pranim i kundërshtuar etj.).

### Forma të korrupsionit

Premtim **për avantazh të pamërituar** në favor të atij që jep kontratën ose tenderin ose që merr pjesë në këtë dhënie:

- pagim parash;
- dhurata (objekte luksi, shpenzime spitalore, shpenzime shkollimi për fëmijët etj.);
- mbulim i shpenzimeve të ndryshme;
- premtim punësimi/stazhesh menjëherë ose më vonë;
- shpenzime akomodimi (udhëtime argëtimi, ftesa të të afërmeve, ftesa me kosto të tepruar);
- veprime sponsorizimi ose patronazhi që kanë ndikime për vendimmarrësin;
- etj.

### Shembuj konkretë

- **Përfituesi** i avantazhit mund të jetë:
  - një përfaqësues i klientit;
  - një agjent i klientit (inxhinier konsulent, zbatues i projektit etj.);
  - ose një i tretë i caktuar nga ai (një i afërm, një fëmijë, një “njeri që huazon emrin”, një shoqëri “guaskë” etj.).



- Premtimi mund të jetë **i fshehur në një kontratë, objekti i së cilës duket i ligjshëm**, por që parashikon shërbime të mbivlerësuara. Kontratat në vijim mund të shërbejnë kështu si mjet për akte korrupsioni (listë jo-shteruese):
  - kontratë asistence tregtare;
  - kontratë studimi;
  - kontratë për ofrim shërbimesh;
  - kontratë nën-kontraktimi;
  - kontratë furnizimi.

Nëse një premtim ose një pagim parash bëhet nga një i tretë (partner i ndërmarrjes së përbashkët/grupimit, bashkëkontraktor, furnizues, agjent etj.) për llogari të ndërmarrjes, ose me pëlqimin e kësaj të fundit, përgjegjësia e ndërmarrjes mund të kërkohej si bashkautore ose bashkëpunëtore.

---

🔹 **Të ndikosh në procesin e vendimmarrjes në kuadrin e zgjidhjes miqësisht ose me gjyq të një mosmarrëveshjeje.**

**Forma të korrupsionit**

Premtim për një avantazh të pamërituar për:

- një gjykatës;
- një arbitër;
- një ndërmjetësues;
- një ekspert.

**Shembuj konkretë**

Të njëjtë si më sipër.

---

🔹 **Të përshpejtosh veprimet ose vendimet e zakonshme të klientit (për shembull: urdhra shërbimesh, pagesa, pranim të punimeve, heqje të rezervave etj.).**

**Forma të korrupsionit**

Premtim për pagim ose pagimi i një avantazhi edhe modest (para ose tjetër) i destinuar ta inkurajojë përfituesin për të kryer punën e tij me zell (i quajtur edhe “pagesë lehtësimi”).

---

## Në kuadrin e marrëdhënieve me agjentët publikë

### MOTIV QË MUND TË ÇOJË NË AKTE KORRUPSIONI:

#### ► Të përpiqesh të marrësh/të përshpejtosh marrjen:

- e një shërbimi;
- e një autorizimi administrativ;
- e një lejeje (leje importi, leje pune);
- e një trajtimi fiskal të favorshëm;
- e shlyerjes së pasojave të shkeljeve;
- e çdo vendim tjetër të favorshëm.

#### Forma të korrupsionit

Premtim për pagim ose pagimi i një avantazhi edhe modest , i destinuar ta inkurajojë përfituesin për të kryer punën e tij me zell (i quajtur edhe “pagesë lehtësimi”).

## Situata të tjera

### MOTIV QË MUND TË ÇOJË NË AKTE KORRUPSIONI:

#### ► Të përpiqesh të marrësh dhënie e një financimi.

#### Forma të korrupsionit

Pagimi i parave ose çdo avantazhi tjetër material një vendimmarrësi.

# RREGULLA TË SJELLJES DHE KËSHILLA



**Korrupsioni, në të gjitha format e tij, është i ndaluar.**

Asnjë bashkëpunëtor i VINCI-t nuk duhet t'i japë një të tretë drejtpërdrejt apo tërthorazi, as të marrë avantazhe të pamërituara, të çfarëdolloj natyre qofshin dhe me çfarëdolloj mjeti, me qëllim që të marrë ose të mbajë një transaksion tregtar ose një trajtim të favorshëm. Çdo bashkëpunëtor do të shmangë marrëdhëniet me të tretë që mund ta vendosin atë personalisht në situatë detyrimi dhe mund të bëjnë të lindë dyshimi mbi integritetin e tij. Ai do të kujdeset, gjithashtu, që të mos e ekspozojë ndaj një situatë të tillë një të tretë, të cilin përpiqet ta bindë ose ta nxisë të përfundojë një marrëveshje me një shoqëri të grupit VINCI.

Bashkëpunëtorët e Grupit nuk duhet **kurrë** të marrin iniciativën të propozojnë avantazhe të pamërituara që mund të cilësohen si korrupsion. Megjithatë, ata mund të ndeshen me situata të shumëllojshme, ku ata janë objekt i kërkesave që vijnë nga të tretë. Ky Kod i sjelljes shpjegon **sjelljen që duhet mbajtur** në raste të tilla.

Ky kapitull ka të bëjë me rregullat e sjelljes dhe këshillat e zbatueshme në situatat me rrezik në vijim:

- marrëdhëniet me klientët në kontratat/tenderët publikë ose privatë;
- përdorimi i një ofruesi shërbimi;
- pagesat e lehtësimi;
- dhuratat e biznesit dhe ftesat;
- kontributet politike, sponsorizimi dhe patronazhi.

Legjenda më poshtë do t'i udhëheqë bashkëpunëtorët në vlerësimin e rrezikut:



**RREZIK MADHOR**



**RREZIK POTENCIAL**

Është e pamundur të jepet një listë shteruese e sjelljeve të lejuara ose të ndaluara, për shkak të shumëllojshmërisë së situatave dhe të konteksteve të ndeshura. Çdo bashkëpunëtor dhe çdo entitet duhet të tregojnë mprehtësi dhe urtësi. Legjenda përbri do t'i drejtojë bashkëpunëtorët në vlerësimin e rrezikut.

Në mënyrë të përgjithshme, çdo bashkëpunëtor që mund të ndodhet në një situatë dyshimi në lidhje me sjelljen që duhet të mbajë, duhet të respektojë rregullin bazë në vijim:

## TRANSPARENÇË

Të mos përpiqet ta zgjidhë çështjen vetëm. T'i flasë për të përgjegjësit të tij hierarkik ose personave të kualifikuar për të asistuar bashkëpunëtorët në këtë fushë (shërbimet juridike ose etike) të entitetit të cilit i përket, të qendrës ose të Grupit.

## Marrëdhëniet me klientët në kuadrin e kontratave/tenderëve publikë ose privatë



Negocimi dhe ekzekutimi i kontratave nuk duhet të lënë shkas sipër sjellje ose vepra që mund të cilësohen si korrupsion aktiv ose pasiv, ose bashkëpunim në ndikim të paligjshëm apo si favoritizëm.

Asnjë pagesë e paligjshme (ose formë tjetër avantazhi) nuk mund të kryhet drejtpërdrejt ose tërthorazi në favor të një përfaqësuesi të një klienti publik ose privat për çfarëdolloj arsyeje qoftë.

Një rrezik korrupsioni ka mundësi të shfaqet në çdo çast kur ai që mban një grimë autoriteti ose pushteti vendimmarrës, vendos ta shfrytëzojë në mënyrë të padrejtë. Në çdo rast, bashkëpunëtorët e VINCI-t duhet të tregojnë urtësi dhe vigjilencë për të shmangur gjetjen në këtë situatë dhe për t'i rezistuar asaj.

### RREGULLA TË SJELLJES:



#### ► Respektimi absolut i ndalimit të paraqitur më sipër.

Nuk ka asnjë përjashtim nga ky rregull. Asnjë leje nuk mund të jepet:

- as nga eprori hierarkik i bashkëpunëtorit;
- as nga departamenti i ngarkuar me çështjet etike të ndërmarrjes.

#### Këshilla

Në rast kërkesë të pagesës së paligjshme, mund të jenë të dobishme veprimet në vijim:

- të shpjegohet që rregullat etike të Grupit nuk lejojnë t'i jepet udhë në mënyrë të favorshme kësaj kërkesë;
- të kujtohet që një pagesë e tillë mund ta ekspozonte kërkuuesin, bashkëpunëtorin dhe ndërmarrjen ndaj ndëshkimeve të rënda, veçanërisht penale;
- t'i kërkohet autorit të kërkesës ta formulojë në mënyrë zyrtare, me shkrim dhe duke përmendur identitetin e tij kërkesën e tij dhe që kjo të jetë e nënshkruar edhe nga superior i tij hierarkik; gjë që do ta shkuraonte atë;
- të paralajmërohet përgjegjësi i klientit duke i treguar se kjo kërkesë mund të vërë në pikëpyetje zhvillimin e projektit dhe se ai duhet të ndërhyjë për t'i dhënë fund kësaj.

#### ► Detyrimi për vigjilencë.

#### Këshilla

Bashkëpunëtorët e Grupit duhet të jenë vigjilentë dhe të mos mbështesin praktika të paligjshme që mund të kryhen nga ortakë, bashkëkontraktorë ose partnerë, për të cilat ata mund të kenë dijeni.

## Përdorimi i një ofruesi shërbimi



Përdorimi i një ofruesi shërbimi duhet të jetë objekt i një zelli të arsyeshëm të përshatur me natyrën e shërbimit dhe me vendin e tij të ekzekutimit. Ky zell ka të bëjë me integritetin e ofruesit të shërbimit, legjitimitetin e kontratës që do të lidhet dhe përputhjen e pagesës me shërbimin e ofruar.

Përdorimi i një ofruesi shërbimi (nënkontraktor, furnizues, konsulent, agjent tregtar etj.) për të kryer disa shërbime është i zakonshëm, por ai mund të jetë gjithashtu një mjet për të fshehur situata korrupsioni. **Një shpërblim i tepruar ose një faturë e mbivlerësuar mund të bëjnë në fakt të dyshohet për një komision të fshehtë.** Prandaj është e nevojshme të jemi veçanërisht vigjilentë.

### RREGULLA TË SJELLJES:

#### ► Përdorimi i një ofruesi shërbimesh duhet të jetë legjitim.

##### Këshilla

Legjitimiteti i përdorimit të ofruesit të shërbimeve nënkupton që shërbimet e pritura të jenë të ligjshme dhe legjitime dhe që t'i korrespondojnë një nevojë reale të ndërmarrjes ose të projektit, në përputhje me rregullat e saj të brendshme, për një çmim koherent me shërbimet e kryera.

Për shembull, përdorimi i një ofruesi shërbimi nuk duhet të motivohet nga interesi për të marrë informacione konfidenciale të siguruar në mënyrë të paligjshme nga ana e një agjenti publik.

#### ► Kushtet e ndërhyrjes së ofruesit të shërbimit nuk duhet të jenë të tilla që të bëjnë të dyshohet për ndershmërinë e ndërmarrjes që i drejtohet atij.

##### Këshilla

Përdorimi i një ofruesi shërbimi supozon paraprakisht disa verifikime dhe masa paraprake:

- integriteti/reputacioni i ofruesit të shërbimit duhet të ketë qenë objekt i kujdesit të arsyeshëm paraprak, në varësi të rrezikut që ai paraqet. Natyra e këtij kujdesi përcaktohet nga entiteti operativ në varësi të hartografisë së rrezeve. Rekomandohet një kërkim sistematik mbi ofruesit e rinj të shërbimeve;
- aftësia financiare dhe teknike e ofruesit që duhet të kryejë shërbimet e pritura, duhet të verifikohet, veçanërisht në lidhje me praktikatat e tregut të vërejtura gjatë studimeve të ofertave të ngjashme;
- rrethanat e përdorimit të ofruesit të shërbimit duhet të jenë legjitime;
- shërbimet e pritura nga ofruesi i shërbimeve duhet të jenë të saktësuar në një kontratë (shiko në vijim).



### ► **Marrëdhënia kontraktore duhet të jetë e qartë.**

#### **Këshilla**

Kontrata që lidh ndërmarrjen dhe ofruesin e shërbimeve duhet të parashikojë:

- përkufizimi saktëson shërbimet e pritura;
  - një shpërblim të arsyeshëm dhe koherent me këto shërbime. Shërbimet teknike (studime, nënkontraktim etj.) mund të japin shkas me të vërtetë për mbifaturim me qëllim të paligjshëm. Bashkëpunëtorët e Grupit duhet të kujdesen që të mos i lejojnë këto praktika në mënyrë të shprehur ose të heshtur;
  - mënyra pagimi transparente (një likuidim i faturave në llogarinë bankare zyrtare të ofruesit të shërbimit, në vendin e tij të vendosjes);
  - një angazhim i qartë për të respektuar rregullat etike të Grupit, shoqëruar me një klauzolë shfuqizimi automatik të kontratës në rast të shkeljes së rregullave etike të Grupit nga ofruesi i shërbimit;
  - një monitorim i dokumentuar i shërbimeve të kryera;
  - një e drejtë e përhershme për auditimin e shërbimeve të kryera.
- 

### ► **Transparencë e fortë.**

#### **Këshilla**

Përdorimi i një ofruesi shërbimi, në varësi të rrezikut që përfaqëson, është objekt i një raporti nga bashkëpunëtori i interesuar pranë eprorit hierarkik dhe departamentit të ngarkuar me çështjet etike të ndërmarrjes.

Shpërblimi i ofruesit të shërbimit duhet të raportohet në mënyrë të qartë dhe të saktë në dokumentet kontabël të ndërmarrjes.

---

## Pagesat e lehtësimit



Pagesat e lehtësimit janë të ndaluara, përveçse nëse preket liria e lëvizjes ose siguria.

“Pagesat e lehtësimit” janë “komisione të vogla ose dhurata të ofruara nëpunësve nga persona privatë (individë, ndërmarrje) për të marrë një shërbim që gjithsesi mund të pretendohet ligjërisht nga kërkuesi, për shembull, për të përshpejtuar një procedurë administrative, për të marrë një leje ose një licencë, ose për të marrë një shërbim bazë si instalimi i një linje telefonike ose përjashtimi nga detyrimet doganore.” (burimi: Transparency International).

Kjo lloj praktike çon në një rreth vicioz duke dobësuar vlerat etike të ndërmarrjes, e cila mund të ndodhë atëherë e ekspozuar ndaj kërkesave gjithnjë e më të shpeshta dhe të rëndësishme. Pra, ato konsiderohen si korrupsion dhe ndalohen nga shumë vende.

Ndërmarrja nuk ka pse e bën këtë lloj pagese për të kryer procedura administrative që nuk përbëjnë një trajtim të privilegjuar ose të pamerituar, por vetëm kryerjen e punës për të cilën shteti i shpërblen nëpunësit e tij publikë.

Shembuj pagesash lehtësimi:

- përfaqësuesi i një agjencie qeveritare vendore kërkon një pagesë jozyrtare për të lëshuar ose përshpejtuar procesin e lëshimit të një autorizimi ose të një lejeje pune;
- një punonjës i një shoqërie publike të furnizimit me energji kërkon një pagesë për lidhjen me rrjetin;
- një agjent i doganave e kushtëzon zhdoganimin e një pajisjeje me pagesën e një gjoja takse të posaçme që mundëson zhdoganimin e shpejtë.

### RREGULLA TË SJELLJES:



#### Pagesat e lehtësimit janë të ndaluara.

##### Këshilla

Nëse një agjent publik kërkon një pagesë lehtësimi, ajo duhet refuzuar. Shpjegojini kërkuesit:

- se rregullat e etikës së Grupit nuk ju lejojnë t'i jepni udhë në mënyrë të favorshme kësaj situate;
- se kërkesa është e paligjshme, (çka ndodh në shumicën dërrmuese të vendeve) dhe se, në përputhje me legjislacionin, ky akt mund të përbëjë një akt të dënueshëm dhe ta ekspozojë kërkuesin, bashkëpunëtorin dhe ndërmarrjen ndaj ndëshkimeve të rënda, veçanërisht penale;
- se procedurat administrative që prisni të kryhen nuk përbëjnë një trajtim të privilegjuar, por kryerjen e punës për të cilën shteti i paguan agjentët e tij publikë/nëpunësit. Në rast këmbënguljeje, kërkoni që kërkesa të formulohet në mënyrë zyrtare (gjë që duhet ta dekurajojë):
  - kërkesë e formuluar me shkrim që saktëson identitetin e kërkuesit;
  - e nënshkruar njëkohësisht dhe nga një përfaqësues i autorizuar;
  - përdorimi i letrës me kokë zyrtare.

Nëse merret kjo gjurmë e shkruar, njoftoni eprorin tuaj hierarkik. Ndërmarrja do të bëjë atëherë çka nevojitet për të siguruar respektimin e të drejtave të saj përmes rrugëve ligjore.

### ► Përfundim: rreziqe për sigurinë dhe lirinë e lëvizjes.

#### Këshilla

Në rastin kur derdhja e një pagese lehtësimi është e nevojshme për të siguruar sigurinë fizike dhe lirinë e lëvizjes së bashkëpunëtorëve, kjo mund të kryhet.

---

### ► Të shoqërohet klienti.

#### Këshilla

- paralajmëroni klientin tuaj duke i treguar se këto kërkesa mund të vënë në pikëpyetje zhvillimin e projektit, nëse ai nuk ndërhyr për t'i ndalur ato;
  - negocioni, paraprakisht, me klientin për të përfshirë në kontratë asistencën e tij në marrjen e autorizimeve të ndryshme administrative të nevojshme, ose marrjen e plotë në ngarkim të tij. Mosmarrja e autorizimeve brenda afateve do të ketë për më tepër pasoja mbi planifikimin (fillim me vonesë i punimeve etj.). Kjo dispozitë do të saktësohet dhe do të përfshihet në kontratë;
  - brenda mundësive, përfshini në kontratat tuaja, planifikimin tuaj, afatet e nevojshme për marrjen e autorizimeve të ndryshme administrative;
  - brenda mundësive, bëjini kërkesat tuaja për marrjen e autorizimeve administrative në mënyrë të grupuar, për ta bërë më të vështirë një refuzim nga ana e agjentëve publikë;
  - vendosni marrëdhënie të mira me organizatat qeveritare kombëtare dhe vendore;
  - diskutojeni me autoritetet temën e kërkesave për pagesa që vijnë nga agjentët publikë vendorë dhe mënyrën për të shmangur shfaqjen e kërkesave të tilla.
- 

### ► Transparencë.

#### Këshilla

Raportojani menjëherë vështirësinë eprorit tuaj hierarkik dhe departamentit të ngarkuar me çështjet etike të ndërmarrjes suaj.

---

## Dhurata biznesi dhe ftesa



Dhuratat ose ftesat mund të ofrohen ose pranohen vetëm kur vlera e tyre është simbolike ose e ulët duke pasur parasysh rrethanat dhe nëse këto nuk janë të tilla që të bëjnë të dyshohet për ndershmërinë e dhuruesit ose paanësinë e përfituesit.

### Dhurata

Është fjala për çdo shërbim në natyrë që mund të konsiderohet si shpërblim. Mund të jetë fjala:

- për dhënien e një objekti material (orë, stilolaps, libër etj.);
- ose mbulimin e një shpenzimi për llogari të përfituesit (shpenzime udhëtimi, fatura shpenzimesh, shpenzime të tjera të çdo natyre).

### Ftesa

Është fjala për çdo operacion të marrëdhënies publike që ka si objekt të ndahet me përfituesin një çast ose një ngjarje ekskluzivisht ose pjesërisht profesionale e këndshme.

Ftesat mund të kenë të bëjnë me:

- një vakt në restorant;
- një shfaqje;
- një udhëtim.

Nëse dhënia e dhuratave të biznesit shpesh konsiderohet si një akt mirësjelljeje dhe kjo praktikë është e zakonshme, duhet treguar një vigjilencë e madhe në mënyrë që praktika në fjalë të mos krijojë një konflikt interesi ose të konsiderohet si një tentativë ose akt korrupsioni.

Parimet e paraqitura në vijim duhet të zbatohen për çdo dhuratë/çdo ftesë, të kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga një i tretë.

### RREGULLA TË SJELLJES:

► **Dhurata ose ftesa e propozuar duhet të jetë e autorizuar nga ligji i zbatueshëm në nivel vendor.**

#### Këshilla

Sigurohuni që dhënia e dhuratës ose ftesa nuk është e ndaluar nga ligji i zbatueshëm, veçanërisht për shkak të statusit të përfituesit.

► **Dhurata ose ftesa e propozuar duhet të jetë në përputhje me politikën e ndërmarrjes.**

#### Këshilla

Përmbajuni këtij Kodi dhe politikës në fuqi në ndërmarrjen tuaj për këtë çështje. Entitetet e Grupit mund të vendosin tavane për çdo ngjarje dhe për çdo periudhë kohe, në varësi të ligjeve të zbatueshme.

► **Duhet të jeni vigjilentë në lidhje me kontekstin/rrethanat.**

**Këshilla**

Dhurata/ftesa duhet të ketë qëllim vetëm shfaqjen e vlerësimit ose të mirënjohjes në mënyrë të përgjithshme.

Ajo nuk duhet parë si shpërblim i përzgjedhjes së ndërmarrjes si fituese e një kontrate.

Nga vlera ose shpeshtësia e saj, dhurata/ftesa nuk duhet të bëjë të dyshohet:

- për ndershmërinë e atij që e ofron atë;
- as për paanësinë e atij që e merr;
- as të ngjallë dyshime të çfarëdolloj natyre qoftë, veçanërisht për konflikt interesi;
- as të mund të interpretohen sikur fshehin një akt korrupsioni.



► **Dhuratat/ftesat janë të ndaluara kur ndërmarrja është duke lidhur një kontratë me entitetin të cilit i përket përfituesi.**

**Këshilla**

Ligjet antikorrupsion e ndalojnë dhënien e dhuratave një të treti me qëllim marrjen e një avantazhi të pamërituar ose ushtrimin në mënyrë të pajustifikuar të një ndikimi çfarëdo mbi çdo veprim zyrtar.



► **Çdo dhuratë/ftesë, përveç atyre me vlerë tepër të ulët, mund të kryhet vetëm me autorizimin paraprak të eprorit hierarkik të bashkëpunëtorit.**

**Këshilla**

- vlera e dhuratës/ftesës duhet të jetë simbolike ose e ulët duke pasur parasysh rrethanat;
- duhet treguar mprehtësi dhe urtësi. Sa më e madhe të jetë dhurata/ftesa, aq më shumë do të jetë e dyshimtë;
- të shmangen dhuratat dhe ftesat që urtësia ju shtyn t'i gjykoni si të papërshtatshme.

► **Çfarë duhet bërë në rast të një kërkesë të tepruar ose të papërshtatshme?**

**Këshilla**

Duhet të refuzohet dhe të shpjegohet:

- që rregullat etike të Grupit nuk ju lejojnë t'i jepet udhë në mënyrë të favorshme kësaj kërkesë;
- që, në bazë të legjislacionit, ky akt mund të ishte i dënueshëm dhe ta ekspozonte kërkuuesin, bashkëpunëtorin dhe ndërmarrjen ndaj ndëshkimeve të rënda, veçanërisht penale.

► **Ftesat e përfaqësuesve të klientëve për vakte duhet të kenë lidhje me veprimtarinë profesionale.**

**Këshilla**

Vakti duhet të trajtojë diskutime të karakterit profesional. Vlera e vaktit është ajo e një vakti profesional të zakonshëm sipas standardeve vendore.



► **Vakti nuk duhet të përfshijë të ftuar jo të lidhur drejtpërdrejt nga veprimtaria profesionale.**

Dy përjashtime ndaj këtij ndalimi:

- marrja nga bashkëpunëtori e autorizimit paraprak të eprorit të tij hierarkik;
- ekzistenca e disa rrethanave të veçanta (festimi i një ngjarjeje domethënëse në zhvillimin e një projekti për shembull).

**Këshilla**

Duhet treguar mprehtësi dhe urtësi.

---



► **Ftesat në evente duhet të kenë karakter profesional dhe të kryhen në praninë e bashkëpunëtorit të VINCI-t që i ka organizuar ato.**

**Këshilla**

Temat e trajtuara duhet të kenë lidhje me veprimtarinë profesionale (shembull: promovim/paraqitje e produkteve ose e shërbimeve të ndërmarrjes).

Këtu mund të jetë fjala, për shembull, për panairë profesionale, seminare, konferenca, vizita ambientesh profesionale që përfshijnë ose jo një udhëtim dhe kosto të arsyeshme akomodimi.

Eventi mund të përfshijë – si shtesë – një çast çlodhjeje ose vizite turistike, por ky aspekt duhet të jetë anësor në raport me qëllimin e udhëtimit.

---



► **Udhëtimet nuk duhet të përfshijnë miqtë, të afërmit, bashkëshortët, fëmijët e të ftuarit dhe palë të tjera të lidhura.**

Një përjashtim ndaj këtij ndalimi:

- marrja nga bashkëpunëtori e autorizimit paraprak të eprorit të tij hierarkik.

**Këshilla**

Duhet treguar mprehtësi dhe urtësi.

---

► **Transparencë e fortë.**

**Këshilla**

Çdo dhuratë ose ftesë:

- përveç atyre me vlerë të ulët, duhet të jetë objekt informacioni nga bashkëpunëtori në fjalë pranë eprorit të tij hierarkik dhe pranë departamentit të ngarkuar me çështjet etike të ndërmarrjes së tij;
  - duhet të dorëzohet në mënyrë të qartë dhe të saktë në dokumentet kontabël të ndërmarrjes.
-

## Kontributet politike, sponsorizimi dhe patronazhi



Çdo kontribut, si kur është politik, si kur ka të bëjë me sponsorizim ose patronazh duhet të lejohet paraprakisht nga drejtoria e përgjithshme e entitetit ekonomik të interesuar.

Nëse këto veprime janë të ligjshme në pjesën më të madhe të vendeve, ato mund të jenë edhe të kritikueshme kur lidhen me kompensime të paligjshme, nga të cilat ndërmarrja mund të përfitojë drejtpërdrejt ose tërthorazi (përmes një shoqërie tjetër të Grupit). Në mënyrë të përgjithshme, dhurimet ose shpenzimet e kryera edhe tërthorazi, për persona publikë, sjellin rreziqe veçanërisht të larta dhe duhet të jenë objekt i një vigjilence të posaçme.

Dallohen veprimet në vijim:



### Kontribute politike

Janë veçanërisht dhurime ose financimet për parti, organizata politike ose sindikale, drejtues të partive politike, të zgjedhur ose kandidatë për funksione politike ose publike.

**Këto kontribute ose janë të ndaluara ose rreptësisht të rregulluara.**

### Sponsorizimi i ndërmarrjeve

Është një mbështetje financiare, me kompetenca ose me materiale që i jepet nga një ndërmarrje dhe pa kërkuar një kompensim të drejtpërdrejtë, një organizmi që ushtron një veprimtari jofitimprurëse, me qëllim që të mbështetet një veprimtari që paraqet një karakter të interesit të përgjithshëm (art dhe kulturë, shkencë, projekte humanitare dhe sociale, hulumtime...). Sponsorit ka një qëllim bujar, veprimi i tij është kryesisht pa interes.

### Patronazhi

Është një teknikë komunikimi ku një ndërmarrje (mbështetës ose "sponsor") kontribuon financiarisht dhe/ose materialisht në një veprim social, kulturor ose sportiv, me qëllim që të nxjerrë një përfitim të drejtpërdrejtë: vizibilitetin e vlerave të ndërmarrjes "sponsor" dhe rritjen e famës së saj. Kontributi i sponsorit nuk analizohet si një dhurim, por si një shpenzim komunikimi; sponsori ka një synim tregtar dhe veprimi i tij është me interes.

Shembuj të situatave me rrezik:

- ndërmarrja juaj ka marrë pjesë në një tender dhe përfaqësuesi i personit publik që e ka organizuar tenderin i sugjeron ndërmarrjes suaj të kryejë një veprim sponsorizimi në favor të një institucioni publik të drejtuar nga një prej miqve të tij;
- përfaqësuesi i një partie politike në pushtet, të ndodhur në një vend ku dhurimet për parti të politike nuk lejohen, i kërkon ndërmarrjes suaj të mbledhë dhurime të destinuara për financimin e funksionimit të partisë. Ndërmarrja juaj ka marrë pjesë në një tender kombëtar në të njëjtin vend.



**RREGULLA TË SJELLJES:** **▶ Çdo dhurim/sponsorizim/patronazh i propozuar duhet të jetë i ligjshëm.**

**Këshilla**

Ky verifikim duhet bërë duke pasur parasysh ligjin e zbatueshëm.

---

**▶ Dhurimi/ sponsorizimi/ patronazhi i propozuar duhet të jetë i lejuar nga politika e ndërmarrjes.**

**Këshilla**

Përmbajuni këtij Kodi dhe politikës në fuqi në ndërmarrjen tuaj për këtë çështje. Qëllimi i operacionit duhet të jetë bindës për sa i përket strategjisë së komunikimit të ndërmarrjes.

---

**▶ Çdo dhurim/sponsorizim/patronazh mund të kryhet vetëm me lejen paraprake të drejtorisë së përgjithshme të ndërmarrjes.**

**Këshilla**

Çdo dhurim/sponsorizim/patronazh i propozuar duhet t'i komunikohet nga bashkëpunëtori i interesuar eprorit hierarkik të tij, i cili do t'ia komunikojë projektin:

- drejtorisë së përgjithshme të ndërmarrjes;
  - departamentit të ngarkuar me çështjet etike të ndërmarrjes, dhe
  - drejtorisë së komunikimit të ndërmarrjes.
- 

**▶ Qëllimi i ndjekur nga ofrimi ose kërkesa për dhurim/sponsorizim/ patronazh duhet të jetë i ligjshëm.**

**Këshilla**

Ligjet antikorruption e ndalojnë ofrimin e dhurimit/ sponsorizimit/patronazhit një të treti, me qëllim marrjen e një avantazhi të pamërituar ose për të ushtruar në mënyrë të pajustificuar një ndikim çfarëdo mbi çdo veprim zyrtar.

Rrethanat e përdorimit të dhurimit / sponsorizimit / patronazhit, vlera e mbështetjes, shpeshtësia e përdorimit të mbështetjes, nuk duhet të bëjnë të dyshohet:

- për ndershmërinë e atij që e ofron atë;
- as për paanësinë e atij që e merr;
- as të ngjallë dyshime të çfarëdolloj natyre qofshin;
- as të mund të interpretohen sikur fshehin një akt korruptioni.

Duhet gjithashtu **të jeni vigjilentë mbi kontekstin/rrethanat**: dhurimet/ sponsorizimet/patronazhet duhet të shmangen kur ndërmarrja është duke lidhur një kontratë me entitetin të cilit i përket kërkuar.

**Dhurimet/sponsorizimet/patronazhet nuk duhen parë as si shpërblim** për përzgjedhjen e ndërmarrjes si përfituese e një kontrate.

---

**▶ Transparencë e fortë.**

**Këshilla**

Çdo dhurim/ sponsorizim/ patronazh duhet të zyrtarizohet dhe dokumentohet. Kështu, për shembull, duhet të saktësohen identiteti i përfituesit dhe përdorimi i parashikuar i dhurimit /sponsorizimit /patronazhit.

Çdo dhurim/sponsorizim/patronazh duhet të jetë objekt i një vlerësimi dhe i një monitorimi nga bashkëpunëtori i interesuar bashkë me eprorin e tij hierarkik dhe departamentin e ngarkuar me çështjet etike të ndërmarrjes.

Çdo dhurim/sponsorizim/patronazh duhet të dorëzohet në mënyrë të qartë dhe të saktë në dokumentet kontabël të ndërmarrjes.

---

# ZBATIMI

## Roli i entiteteve të Grupit

Çdo entitet i grupit VINCI ka përgjegjësinë të kujdeset për zbatimin siç duhet të këtij Kodi të sjelljes antikorruption.

I takon asaj të vlerësojë rreziqet e korrupsionit me të cilat përballet, në varësi nga vendi ose vendet ku ushtron veprimtaritë e saj, natyra e veprimtarive dhe e bashkëkontraktorëve. Ky vlerësim mbështetet mbi një metodë të përpunuar në lidhje me mekanizmin e kontrollit të brendshëm.

## Roli i bashkëpunëtorëve

Respektimi dhe zbatimi i këtyre rregullave janë të detyrueshme për të gjithë bashkëpunëtorët, sipas funksioneve dhe përgjegjësi të tyre. Secili duhet të jetë vigjilent për veten e tij, por edhe për ata përreth tij, në ekipin e tij ose ndaj personave që janë nën përgjegjësinë e tij.

Në rast pyetjesh ose vështirësish në lidhje me këto rregulla dhe zbatimin e tyre brenda Grupit, çdo bashkëpunëtor duhet t'ia komunikojë ato eprorit të tij hierarkik ose personave të kualifikuar për ta ndihmuar (shërbimet juridike ose shërbimet e ngarkuara me çështjet etike). Ai mund t'i drejtohet gjithashtu Referentit etik të VINCI-t.

## Mekanizmi i alarmit të brendshëm

Nëse një bashkëpunëtor vlerëson se një dispozitë ligjore ose nën-ligjore, ose që këto rregulla nuk janë respektuar ose janë duke mos u respektuar, ai duhet të informojë për këtë sa më shpejt që të jetë e mundur eprorin e tij hierarkik ose të përdorë mekanizmin e alarmit profesional të entitetit të cilit i përket ose të Grupit, në respektim të rregullave në lidhje me këtë mekanizëm, të ligjit të zbatueshëm dhe të rregullave të brendshme të ndërmarrjes së tij.

## Regjimi disiplinor - ndëshkimet

Rregullat e këtij Kodi të sjelljes antikorruption janë të detyrueshme. Askush brenda Grupit nuk mund të përjashtohet nga to, pavarësisht nga niveli i tij hierarkik.

Çdo veprim i kryer në shkelje të këtij Kodi të sjelljes antikorruption mund të sjellë ndëshkime disiplinore. Ai do të përbënte një **gabim të tillë që justifikon zbatimin e ndëshkimeve disiplinore**, pa përjashtuar asnjë veprim juridik që mund të ndërmerrej nga ndërmarrja.

Çdo veprim i kryer në shkelje të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në fushën e **luftës kundër korrupsionit**, mund të sjellë gjithashtu ndëshkime disiplinore dhe penale për bashkëpunëtorin e interesuar dhe ndëshkime penale për punëdhënësin e tij (shembuj: ndëshkim financiar, dënim me burg, përjashtim nga tenderët publikë).

Ndëshkimet dhe ndjekjet e përshtatshme janë ato që parashikon e drejta e zbatueshme për bashkëpunëtorin e interesuar dhe që merren në respektim të procedurave ligjore të zbatueshme dhe veçanërisht në respektim të të drejtave të garantuara të zbatueshme për bashkëpunëtorin në fjalë.

Ndëshkime të tilla, në respektim të ligjit të zbatueshëm, mund të përfshijnë veçanërisht pushimin nga puna për shkak gabimi dhe kërkesa për dëmshpërblim me iniciativën e VINCI-t, edhe nëse mosrespektimi i rregullave është zbuluar nga vetë Grupi në kuadrin e një kontrolli të brendshëm.



R E A L  
SUCCESS  
I S T H E  
SUCCESS  
YOU SHARE

**VINCI**

1973, boulevard de La Défense  
CS 10268  
F-92757 Nanterre Cedex  
Tel.: +33 1 57 98 61 00  
[www.vinci.com](http://www.vinci.com)

